

VENDIM
Nr. 275, datë 13.12.2024

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 206, DATË 7.10.2024

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar; të nenit 105, germa “c”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 249/1 prot., datë 11.12.2024, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 206, datë 7.10.2024 dhe mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 206, datë 7.10.2024, vendosi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shtator 2024 prej 16.86 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

- Në vijim të këtij vendimi, ju kërkua shoqërisë “FSHU” sh.a. të paraqesë faturat dhe dokumentacionin për energjinë elektrike të prokuruar në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX) për muajin shtator 2024, me qëllim vlerësimin dhe transparencën në përllogaritjen e kostos mesatare të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt).

- Në përgjigje, më datë 14.10.2024, “FSHU” sh.a. përcolli dokumentacionin e kërkuar, duke përfshirë: faturat e blerjes së energjisë elektrike për muajin shtator 2024; tabelat përmbledhëse ditore; tabelat e përllogaritjes për aplikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët 35 kV.

- Pas shqyrtimit të materialeve të përcjella nga “FSHU” sh.a., me shkresën nr. 2024/4 prot., datë 11.11.2024, ERE i kërkoi shoqërisë informacion dhe sqarime mbi dy çështje kryesore:

1. Diferencat e konstatuara ndërmjet çmimeve orare të blerjes së energjisë në tregun ALPEX për muajin shtator 2024 dhe çmimeve orare të paraqitura në aplikimin për miratimin e çmimit FMF 35 kV, të cilat reflektohen edhe në përllogaritjen e çmimit mesatar të ponderuar ditor.

2. Profilin e pandryshuar të sasive të nominuara për nivelin e tensionit 35 kV gjatë çdo ore të ditës në ALPEX, në krahasim me profilet e ndryshme të përdorura për tensionin 20/10/6 kV gjatë të njëjtës periudhë.

- Me shkresën nr. 7110/1 prot., datë 25.11.2024 (protokolluar në ERE me nr. 2024/7 prot., datë 25.11.2024), “FSHU” sh.a. ofroi sqarimet e kërkuara mbi këto çështje: “1. Për sa konstatuar nga ana juaj dhe analizuar nga ana jonë, rezulton se diferenca në përllogaritje ka ardhur si rezultat i rrumbullakosjes së sasisë orare të nominuar, përkatësisht: Nga parashikimi për blerjen e energjisë për klientët e kategorisë FMF 35 kV, sasia orare që do të nominohet në platformën e tregtimit të ALPEX nga “FSHU” sh.a. ka qenë 0.16919 mwh. Duke qenë se bazuar në “Procedurat e tregtimit” në sistemin e ALPEX-it mund të nominohet deri në 2 (dy) shifra pas presjes dhjetore, kjo sasi është rrumbullakosur në 0.17 mwh.

Në kërkesën për miratimin e çmimit dhe tabelën e përllogaritjeve pranë ERE, formula e ka llogaritur çmimin me sasinë 0.16919... mwh (pra 5 shifra pas presjes), dhe jo 0.17 mwh. Si rezultat çmimi orar, i llogaritur si: vlera e faturës mbi bazë orare rezultuar nga blerja në ALPEX/sasinë orare

(0.16919 mwh dhe jo 0.17 mwh), ka rezultuar me një diferencë të vogël, e cila reflektohet edhe në koston mesatare të ponderuar të blerjes së energjisë për këtë muaj. Çmimi mesatar i ponderuar ka rezultuar 13.01 lekë/kwh dhe çmimi i shitjes së energjisë aktive 16.86 lekë/kwh.

“FSHU” sh.a. ka kryer sërish përlllogaritjet duke marrë parasysh sasisë orare të nominuara në ALPEX prej 0.17 mwh, çmimet orare, dhe vlerat orare të faturave, dhe rezulton se çmimi mesatar i ponderuar për muajin shtator 2024 është 12.95 lekë/kwh. Duke i shtuar edhe kostot e tjera për sa parashikohet në “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me vendimin nr. 201 datë 4.12.2017, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar, çmimi i energjisë aktive rezulton prej 16.80 lekë/kwh.

Diferenca me çmimin e përcaktuar në kërkesën për miratimin nga ana e “FSHU” sh.a., si dhe miratuar nga ERE me vendimin nr. 206, datë 7.10.2014 është 0.06 lekë/kwh. Sqarojmë se “FSHU” sh.a. do të marrë të gjitha masat për kompensimin e kësaj difference për klientët FMF të lidhur në 35 kV. 2. Për sa i përket konstatimit tuaj që sasisë e nominuara të energjisë elektrike për nivelin e tensionit 35 kV mbeten të pandryshuara, sqarojmë se kërkesat për blerjen në “Tregun e Ditës në Avancë” (ALPEX) bazohen në vlera të parashikuara që rrjedhin nga të dhëna historike të disponueshme.”

- Gjithashtu, “FSHU” sh.a., me anë të shkresës së sipërcituar, na informoi se duke filluar nga data 1 nëntor 2024, sasisë e energjisë për këtë kategori klientësh po nominohen me profile të ndryshme ngarkese për çdo orë të ditës.

- Për sa më sipër, vlerësohet se për shkak të rrumbullakosjes së sasisë orare të nominuar, konsumatorët e tensionit 35 kV gjatë shtatorit 2024 janë furnizuar me energji me një çmim 0.06 lekë/kwh më të lartë se kostoja reale, duke cenuar përputhshmërinë me kostot aktuale.

- Bazuar në parashikimet e “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në mbështetje të nenit 105, germa “c”, citojmë se: Aktet administrative kanë fuqi prapavepruese në rastin kur organi kompetent mund t’i jap fuqi prapavepruese aktit kur kjo lejohet nga ligji dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë.

- Në këtë rast, ndryshimi i çmimit të përcaktuar me vendimin nr. 206/2024 të ERE-s, i bazuar në të dhënat e sakta dhe të përditësuara mbi kostot reale të blerjes së energjisë elektrike nga “FSHU” sh.a., përmbush parimet ligjore, që çmimi të reflektojë kostot.

- Ky ndryshim është në favor të konsumatorëve, duke garantuar një transparencë më të lartë dhe një përputhshmëri më të saktë me kostot aktuale, ndërsa nuk cenon të drejtat e ndonjë pale të tretë. Për më tepër, rillogaritja e çmimit përmbush parimet e metodologjisë, pasi këto veprime synojnë një përmirësim të përlllogaritjeve bazuar në të dhëna të sakta, duke respektuar rregullat e metodologjisë pa ndryshuar apo devijuar nga parimet e saj themelore.

- Bazuar në nenin 105, germa “c”, të Kodit të Procedurave Administrative, i cili lejon efektin prapaveprues të një akti administrativ kur është në favor të palëve të interesuara dhe nuk cenon të drejtat e palëve të treta, rillogaritja dhe përcaktimi i çmimit të korrigjuar konsiderohet i justifikuar dhe në përputhje me parimet ligjore dhe aktet nënligjore të ERE-s.

- Për këtë arsye, vlerësohet ndryshimi i pikës 1 të dispozitivit të vendimit nr. 206, datë 7.10.2024, nga: “Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin shtator 2024 prej 16.86 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.”, në: “Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin shtator 2024 prej 16.80 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.”.

- Gjithashtu, shoqëria “FSHU” sh.a. duhet të korrigjojë dhe kompensojë diferencat e rezultateve të muajit shtator 2024 në faturat e muajit dhjetor 2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit nr. 206, datë 7.10.2024, e Bordit të ERE-s ndryshon dhe bëhet: “Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shtator 2024 prej 16.80 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.”.

2. Pika 2, e vendimit nr. 206, datë 7.10.2024, e Bordit të ERE-s ndryshon dhe bëhet: “Shoqëria të korrigjojë dhe kompensojë diferencat rezultuese të muajit shtator 2024, në faturat e muajit dhjetor 2024.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti